



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010 dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjes dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Kryeqytetit,

th ë r r e t

mbledhjen e **dytë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **27.4.2026** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Kryeqytetit.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim-vendim për miratimin e Planit të veprimit për shërbime sociale 2026–2028;
3. Propozim-vendim për lënie në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01-110/1205 (K.Pr.) për shërbimin e transportit me "Merimangë" për territorin e komunës së Prishtinës;
4. Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 01-030/01-236535/23 (K.Pr.) për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës;
5. Raporti konsolidues i performancës financiare dhe operative të ndërmarrjes "Prishtina Parking";
6. Propozim-vendim për subvencionimin e NPL "Prishtina Parking";
7. Raporti financiar buxhetor i kryeqytetit, (TM1) 2026;
8. Propozim-vendim për bartja e mjeteve nga vitit 2025 në vitit 2026;
9. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të pjesëve të parcelave kadastrale nr. P-71914059-06118-1 dhe P-71914059-06119-3 për NP "Termokos", SHA;
10. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të një pjese të parcelës kadastrale nr. P-71914059-07090-21 për NP "Termokos", SHA;

11. Rregullore për plotësim ndryshimin e Rregullores për menagjimin e varrezave dhe objektit komemorativ në Komunën e Prishtinës:
12. Propozim-vendim për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për “Muzeun e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës në Kosovë”, i themeluar dhe menaxhuar nga “Fondacioni Jahjaga”;
13. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-060/01-54118/26 më, 15.4.2026

KRYESUES I KOMITETIT
Fehmi Kupina

